REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 338, Datë 06.11.2026

MBI

REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "EZ-5 ENERGY" SH.P.K. TË LIDHUR ME CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; nenit 6 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2707/3 prot., datë 05.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 523, seria P22, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2707 prot., datë 08.09.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për saktësimin e veprës ndihmëse (sistem akumulimi energjie) në Aneksin A të Licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, duke kryer dhe pagesën përkatëse për modifikimin e licencës.
- Me shkresën nr. 2707/1 prot., datë 14.10.2026, ERE i ka sqaruar shoqërisë se me vendimin nr. 230, datë 18.08.2026, janë miratuar "*Rregullat për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar"*, dhe i ka kërkuar që të bëjë sqarimin përkatës duke evidentuar veçmas njësitë e depozitimit për të cilat është miratuar më parë modifikimi i licencës (nëpërmjet vendimit të bordit të ERE-s nr. 100, datë 09.04.2026) si dhe të plotësojë Formularin e Regjistrimit së bashku me dokumentacionin shoqërues, në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2707/2 prot., datë 23.10.2026, shoqëria ka sqaruar se nëpërmjet aplikimit aktual kërkohet shtimi i një kapaciteti të ri energjetik depozitimi prej 200 MWh dhe po ashtu ka depozituar formularin e plotësuar dhe dokumentacionin shoqërues.
- Referuar të dhënave të Formularit të Regjistrimit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se shoqëria "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. ka paraqitur dokumentacionin për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "EZ5 BEES 200MW", me fuqi nominale

ngarkimi/shkarkimi 10 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 200 MWh, në përputhje me kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe të "*Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026.

- Për sa më sipër, vlerësohet se plotësohen kushtet për vijimin e procedurës së regjistrimit të këtij impianti në kuadër të licencës nr. 523, seria P22, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka detyrimin që, gjatë operimit të centralit fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW dhe impiantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 10 MW, të respektojë kufirin e fuqisë aktive totale të injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin, sipas parametrave teknikë dhe kushteve të përcaktuara nga operatori i rrjetit. Për sa i përket pikës së lidhjes së impiantit me rrjetin, vlerësohet të përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të depozitimit të amendimit përkatës të pikës së lidhjes me "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a.
- Shoqëria i nënshtrohet regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, brenda afatit dhe kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë. Për vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike pas përfundimit të regjimit kalimtar, shoqëria ka detyrimin të ndjekë procedurën përkatëse të licencimit ose të modifikimit të licencës ekzistuese, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
- Për këtë vendimmarrje vlerësohet që të njoftohen dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe shoqëria OSSH sh.a.
- Në lidhje me pagesën e kryer nga shoqëria vlerësohet që të rakordohet në vijim duke marrë në konsideratë rregullimet në raport me detyrimet financiare të pagesave të rregullimit që shoqëria do të ketë ndaj ERE-s për vitin 2027.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të regjistrojë impiantin e depozitimit të energjisë elektrike "EZ5 BEES 200MW", të deklaruar nga shoqëria "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., me fuqi nominale ngarkimi/shkarkimi 10 MW dhe kapacitet energjetik depozitimi 200 MWh, të lidhur me centralin fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, për të cilin shoqëria disponon licencën nr. 523, Seria P22, të dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022.
2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, regjistrohet në kuadër të regjimit kalimtar dhe lejohet të operojë gjatë periudhës kalimtare të përcaktuar në nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike", duke respektuar kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit, përfshirë kufirin e lejuar të fuqisë aktive totale të injektuar në pikën e lidhjes me rrjetin.
3. Për operimin e impiantit të depozitimit pas datës 14.07.2027, shoqëria duhet të aplikojë për licencën përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Çdo ndryshim në të dhënat e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet nga shoqëria në ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të marrë masat për regjistrimin dhe pasqyrimin e të dhënave të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike në regjistrin përkatës të ERE-s dhe në fletën individuale të regjistrimit, në përputhje me rregullat në fuqi, përfshirë çdo ndryshim të këtyre të dhënave të njoftuar nga shoqëria sipas pikës 4 të këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI